



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 45 Prot.,

Tiranë, 01.032024

VENDIM

Nr. 37, datë 01.03.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.03.2024:

VENDOSI:

- Mosmiratimin e projektit “Restaurimi, përshtatje dhe rijetëzimi i banesës së z. Muhamet Veli Avduli K-102, lagjja Kala-Berat”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, Brenda Kufirit Qendër Historike Berat, me aplikues dhe zhvillues z. **Muhamet Avduli**, me argumentin:
 - Propozimi bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, Neni 5, Pika 36 “Monument Kulture”, gërma b), ku citohet se “Monument Kulture i Kategorisë së II-të është ndërtimi me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme”.
 - Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 - Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 - Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI



KRYETAR
Blendi GONXHJA